



Tetë çështje...  
që e bëjnë të  
fortë edukimin.

Tetë çështje...  
që e bëjnë të  
fortë edukimin.

# Përmbajtja.

---

Çfarë është edukimi? _____	6
Tetë çështje që e bëjnë të fortë edukimin. _____	8
Edukimi është që të dhurosh dashuri. _____	9
Edukimi është që të lejohet grindja. _____	10
Edukimi është që të mund të dëgjosh. _____	12
Edukimi është që të caktosh kufi. _____	13
Edukimi është që të japësh hapësirë të lirë. _____	15
Edukimi është që të tregosh ndjenja. _____	17
Edukimi është që të kesh kohë. _____	18
Edukimi është që të japësh zemër. _____	20
Këshilla dhe ndihma për familje të forta. _____	22



# Çfarë është edukimi?

---

Së pari: edukimi nuk u përket vetëm prindërve, por të gjithëve, sepse ai është një detyrë e gjithë shoqërisë. Edukimi duhet t'i bëjë fëmijët të fortë në shumë aspekte: për të vendosur për jetën e tyre, për t'i përballuar sfidat, për të lidhur marrëdhënie, për të duruar dështime, për të pranuar mendime të tjera dhe shumë më shumë. Së pari, kjo do të thotë që fëmijët të furnizohen me të gjitha gjërat e nevojshme për jetën. Ata kanë nevojë për ushqime dhe rroba, ngrohtësi dhe mundësinë për ta eksploruar botën. Por edukimit i takojnë edhe diskutimi aktiv për t'ua mundësuar vajzave dhe djemve fitimin e dijeve dhe të aftësive. Fëmijët duhet të lejohen që të bëjnë përvoja dhe në rrugën e tyre të jetës ata kanë nevojë për një shoqërim të besueshëm, për të qenë në gjendje që të zënë vendin e tyre në shoqërinë tonë.

---

Fëmijët kanë shumë shembuj në mjedisin e tyre: Prindërit, pedagogët në kopshtin e fëmijëve, shkollën, strehën ditore ose vendtakimin e të rinjve dhe njerëzit e tjerë, të cilët takojnë në jetën e përditshme, por edhe figurat nga mediat. Më të rëndësishmet janë të rriturit me të cilët ata bashkëjetojnë. Prandaj, sjellja e tyre është me rëndësi të veçantë.

Prindërit e mbajnë përkujdesjen kryesore për mirëqenien e fëmijëve të tyre. Prandaj, edukimi do të thotë për ata që të kenë detyrime, por edhe të drejta. Ashtu siç fëmijët kanë një të drejtë për kushte pozitive të jetës, është e drejta e personave edukues që të mbështeten nga bashkësia.

Edukimi është një proces i gjallë dhe tërheqës. Vërtet ai mund të jetë ngandonjëherë i lodhshëm, por mbi të gjitha krijon kënaqësi dhe është i rëndësishëm për shoqërinë. Me edukim të fortë bota përfiton më shumë nga fëmijët e saj dhe fëmijët përfitojnë më shumë nga bota.



## Për një edukim të suksesshëm prindërit kanë nevojë

- ▶ për kushte të mira të përgjithshme: Familjet kanë nevojë për hapësirë të mjaftueshme banimi, vende të sigurta pune, ndihma financiare, mundësi të mira përkujdesjeje për fëmijët dhe për një ambient të favorshëm për familjet.
- ▶ Ndhime dhe mbështetje: Prindërit kanë të drejtë që të lehtësohen herë pas here. Ngandonjëherë, familjet mund të ndihmojnë njëri-tjetrin. Përveç kësaj, miqtë, kolegët, të afërmit dhe komshinjtë janë me rëndësi për të qëndruar pranë familjeve me mirëkuptim, këshilla dhe vepra. Nëse familjet, gjatë edukimit, nuk dinë më si të vazhdojnë, kjo nuk është turp. Ndhima për të rinjtë, ofruesit e masave të formimit të prindërve, këshillimorët për çështje martesore dhe të familjeve ndihmojnë me gjithë qejf dhe mënyrë individuale.

# Tetë çështje që e bëjnë të fortë edukimin.

---

Si duket një "edukim i fortë"? Prindërit sot mund të zgjedhin nga një baticë e vërtetë revistash dhe librash me këshilla të mira. Ne nuk duam të shtojmë edhe një doracak tjetër në çështje edukimi. Ekipi i fushatës "I/e fortë me edukim" ka formuluar tetë pika thelbësore, të cilat i përmbajnë tiparet thelbësore të një „edukimi të fortë“.

---

## EDUKIMI ËSHTË ...

- ... që të dhurosh dashuri.
- ... që të lejohet grindja.
- ... që të mund të dëgjosh.
- ... që të caktosh kufi.
- ... që të japësh hapësirë të lirë.
- ... që të tregosh ndjenja.
- ... që të kesh kohë.
- ... që të japësh zemër.



# Edukimi është ... që të dhurosh dashuri.



T' i dhurosh një fëmije dashuri, kjo do të thotë që ta pranosh siç është dhe t'ia tregosh atë. Fëmijë dhe të rinj kanë nevojë për këtë ndjenjë të ngrohtësisë për të zhvilluar vetëbesim dhe për t'u njohur pa frikë me pikat e tyre të forta dhe ato të dobëta. Por ngandongëherë nënat dhe baballarët e kanë të vështirë që të tregojnë dashurinë e tyre. Si funksionon atëherë dhurimi i dashurisë.

- ▶ Forma më e drejtpërdrejtë që të dhurohet dashuri është prania trupore, ngrohtësia dhe kontakti. Qoftë një përqafim, qoftë ledhatimi me të kruar të butë, një kontakt i këndshëm vështrimi, një shtyrje e butë ose rrahje mbi shpatullat: Çdo fëmijë di menjëherë çfarë do të thotë.
- ▶ Aq më të mëdhenj bëhen fëmijët, aq më të rëndësishme bëhen forma të tjera të dashamirësisë. Adoleshentët – djemtë si dhe vajzat – lënë ngandonjëherë me gjithë qejf që të përqafohen, edhe pse ata, me kalimin e kohës, kërkojnë të tjerë për t'i puthur.
- ▶ Të kesh kohë, të tregosh interes dhe të ngushëllosh, kjo tregon një fëmije sa e duan prindërit të tyre. Tregoni fëmijët tuaja se i keni për zemër dhe të jeni krenar për ta, pavarësisht nga rezultatet e veçanta.
- ▶ Por, të dhurosh dashuri nuk do të thotë se të rriturit nuk mund të kërkojnë një herë qetësinë e tyre ose mund t'ua ndalojnë diçka fëmijëve.



# Edukimi është ... që të lejohet grindja.



Grindje ka në çdo familje. Gjatë kësaj mund të jetë ngandonjëherë edhe pak më e zhurmshme. Të mbash veten, të thash "jo", të durosh tensione, t'i dallosh nevojat e të tjerëve, të bindesh, të nënshtrohesh, të gesh kompromise dhe të pajtohesh: Gjatë grindjes fëmijët ushtrojnë aftësi të rëndësishme sociale. Grindja duhet të mësohet. Që një konflikt mund të zgjidhet përsëri dhe të mos krijohen akoma më shumë tensione, duhet të respektohen disa rregulla:

- ▶ Asnjë temë nuk është e ndaluar parimisht. Fëmijët mund të tregojnë edhe ndjenja negative si antipati ose inat, pa u ndëshkuar për këtë.
- ▶ Të rriturit e kanë hapin më të madh. Prandaj ata nuk duhet t'i lëndojnë fëmijët me fjalë ose forma të dhunës, por duhet t'i marrin seriozisht me dëshirën e tyre.
- ▶ Përderisa njëri nuk zemërohet me tjetrin, atëherë edhe pas grindjes mund të qëndrojnë dy mendime njëri pranë tjetrit. Lidhur me këtë fëmijë dhe të rritur mësojnë të ushtrojnë tolerancë.
- ▶ Fëmijë mund të zihen me njëri-tjetrin pa ndërhyrje të menjëhershme të të rriturve. Por, nëse ata tregohen të padrejtë ndaj më të dobëtëve, ata duhet të kërkohen me dashuri por qartësisht që të tregojnë kujdes.

- ▶ Të rriturit janë shembuj të rëndësishëm. Nëse fëmijë përjetojnë si prindërit e tyre bëjnë diskutime plotë respekt , ata mësojnë nga kjo. Fëmijë vuajnë nga konfliktet që digjen pa flakë, sherret e dhunshme ose akuzat fyese brenda familjes. Në varësi nga mosha e fëmijëve, të rriturit mund t'u shpjegojnë atyre për çfarë bëhet fjalë në një grindje pa i tërhequr në njërin anë.
- ▶ Po aq e rëndësishme sesi të lejohet grindja është edhe që të pajtohesh përsëri. Në rast të një grindjeje të ngecur, prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët me këshilla. Në rast të grindjeve brenda familjes duhet të pajtohuni prapë para shtrimit për të fjetur.



# Edukimi është ... që të mund të dëgjosh.



Të dëgjosh do të thotë që t'i japësh dikujt vëmendje dhe të marrësh me dëshirën e tij. Adoleshentë, të cilët bëjnë ditë për ditë përvoja të reja dhe duhet të orientohen në botë, kanë nevojë në mënyrë të veçantë për veshin e hapur të të rriturve. Në çdo familje duhet të kishte në jetën e përditshme rregullisht raste për biseda, qoftë një konferencë familjeje ose rituale, si darka e përbashkët ose dërgimin e fëmijëve në krevat. Të dëgjosh me vëmendje mund të jetë e vështirë. Lidhur me këtë mund të ndihmojnë gjërat e mëposhtme:



- ▶ Ngandonjëherë në fund të një fjalie ka informacione, të cilat nuk i keni pritur fare në fillim. Prandaj: lëreni tjetrin që të shprehet deri në fund!
- ▶ Komete ose këshilla të ngutura nuk ndihmojnë më tej. Fëmijë e ndjejnë veten të marrë më seriozisht kur prindërit bashkë me ata hartojnë zgjidhje të përbashkëta.
- ▶ Për të mos u krijuar fare mosmarrëveshje duhet të sigurohuni ndaj njeri-tjetrit nëse keni kuptuar njëri-tjetrin.

- ▶ Një bisedë e mirë duron vetëm pak argëtim. Pra, mbylleni televizorin dhe lëreni që të bie zilja e telefonit!
- ▶ Nëse fëmijët tregojnë në mënyrë tepër të hollësishme për përjetimet e tyre, atëherë lejohet edhe që të

frenohen në lumin e fjalëve të tyre. Fëmijë, të cilët janë më shumë të qetë, duhet të inkurajohen për të folur, sidomos kur ata janë më të heshtur se zakonisht.

## Edukimi është ... që të caktosh kufi.



Të caktosh dhe të respektosh në mënyrë konsekuente kufi, kjo është detyra më e rëndësishme për shumë prindër, por edhe sfida më e madhe në edukim. Fëmijë dhe të rinj janë mjeshtër të lindur kur bëhet fjalë për të provuar durimin dhe konsekuencën e prindërve. Fëmijë kanë nevojë për kufi për arsye të dyllshme: Në njërën anë, për t'u mbrojtur nga rreziqet brenda dhe jashtë shtëpisë. Në anën tjetër, rregulla me kuptim dhe të qartë i japin siguri fëmijës. Ngandonjëherë të rriturit e kanë të vështirë që të veprojnë kundër vullnetit të fëmijëve. Por, për prindër dhe për fëmijë në afat të gj atë, është më lehtë kur ata dinë ku janë kufijtë e tyre. Edhe lidhur me këtë duhet të vlejnjë rregulla të caktuara të lojës:

- ▶ Kufijtë duhet të përcaktohen qartë. Të rriturit fillimisht duhet të mendojnë mirë pse e përcaktojnë një rregull të caktuar. Fëmijë më të moshuar kuptojnë një urdhër ose një ndalim më mirë, kur të rriturit ua shpjegojnë arsytet.
- ▶ Kush përcakton kufi duhet të jetojë edhe vetë sipas tyre. Kjo nuk do të thotë se mama ose babi duhet të bien të flenë bashkë me të vegjlit pas "shkurtabiqit të gjumit". Por në rast të pastrimit të rregullt të dhëmbëve ata janë shembulli më i mirë.
- ▶ Të përcaktosh kufi dhe mos t'i respektosh ata nuk ka kuptim. Konsekuenca tregon besueshmëri dhe ua jep fëmijëve ndjenjën që të merren seriozisht.
- ▶ Nëse një fëmijë kapërcen një kufi të përcaktuar, atëherë të rriturit duhet të reagonin në mënyrë të njëllojtë- Fëmijë dinë për çfarë bëhet fjalë, kur rregullat e përcaktuara nga nëna, babai dhe të tjerët që marrin pjesë në edukim janë të ngjashme në pika thelbësore, edhe kur ata edukojnë në mënyrë të ndryshme. Ngandon-  
jëherë nuk mjafton një "jo" e qartë ose një paralajmërim. Në qoftë se ka nevojë për masa konsekuente, atëherë ato duhet të jenë në lidhje të drejtpërdrejtë me situatën. Fëmijë në shumicën e rasteve i kuptojnë mirë "ndëshkimet logjike".
- ▶ Edhe prindërit duhet t'i përmbajnë kufijtë gjatë edukimit. Të gjitha format e dhunës janë tabu. Këtu përfshihen jo vetëm rrahje, por edhe dhuna shpirtërore si refuzimi i dashamirësisë.
- ▶ Asnjë rregull pa përjashtim. Të tërhiqesh nga një rregull, meqenëse ai nuk ka pasur kuptim, ose t'ia përshtatësh një situatë të ndryshuar, nuk do të thotë fundi i edukimit. Fëmijë dhe të rinj nuk e humbasin menjëherë respektin nga kufijtë e përcaktuar nga prindërit, nëse ata lejohen një herë të rrinë më gjatë të zgjuar.

# Edukimi është ... që të japësh hapësirë të lirë.



Fëmijë kanë nevojë për hapësira, të cilat mund të formojnë vetëm ata. Që nga moshë një vjeç ata fitojnë gjithnjë dhe më shumë hapësira. Ata mësojnë që të hanë vetëm, të shkojnë vetëm në banjë, të jenë të ndarë nga prindërit për një kohë të gjatë, të përdorin paratë e veta dhe shumë gjëra të tjera. Hapësira të lira janë të rëndësishme për të përballuar jetën në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi. Që vendimi midis lëshimit dhe mbrojtjes nuk bëhet tepër e vështirë për prindërit, ata duhet të mendojnë për ato që vijnë:

- ▶ Hapësirat e lira duhet të provohen. Vajzat dhe djemtë që përfshihen në jetën e përditshme të familjes mësojnë shumë për jetën e mëvonshme. Kush lejohej herë pas here t'ua hidhte një sy mbi shpatullat e nënës ose babait, mund të lexoj së shpejti edhe vetëm hartën e qytetit ose mund ta riparojë biçikletën e tij.
- ▶ Fëmijët mësojnë hap pas hapi që t' i përdorin liritë. A mund të përdorin nxënës të klasës së parë pak para xhepi, të paguar një herë në javë, a shkojnë të rinjtë mirë me një llogari të vetë, në të cilën prindërit transferojnë çdo muaj para xhepi dhe ndoshta edhe një shumë paradhënie për sendet shkollore dhe rrobat.

- ▶ Ndhimat u japin fëmijëve siguri në testimin e hapësirave të reja. Të pajisur me një celular ose një kartë telefoni, udhëtimi i parë vetëm te shoqja në një lagje tjetër nuk është aq e kërcënueshëm për një njëmbëdhjetëvjeçare – dhe më pak acarues për nervat e prindërve.
- ▶ Në çështjet e shijes brezat e ndryshme nuk janë gjithmonë të një mendimi. Nëse bëhet fjalë për një hobi, modat e mbajtjes së flokëve ose miqtë, fëmijë parimisht duhet të lejohen të vendosin vetë - derisa rregullat e përcaktuar nga prindërit nuk kapërcehen. Toleranca i ka

kufijtë e saj nëse bëhet fjalë për mirëqenien e fëmijëve. Nëse adoleshentët fillojnë të pinë duhan, kjo me siguri nuk kontribuon në zhvillimin e tyre.

- ▶ Gjatë pubertetit shumë të rinj kërkojnë papritmas hapësira të lira të mëdha, madje ata me natyrë zemërbutë bëhen rebele kundër paracaktimeve të prindërve. Që të mos e humbasin tokën nën këmbët, vajzat dhe djemtë në këtë kohë kanë nevojë për përvojën se nuk ka liri pa kufi. Në anën tjetër prindërit duhet t'ua ndihmonin që të ecën në rrugën e vet dhe të bëhen të rritur.



# Edukimi është ... që të tregosh ndjenja.



Dashuri dhe gëzim, pikëllim dhe inat – ndjenjat i përkasin jetës në familje. Fëmijët i tregojnë ndjenjat në mënyrë të ndryshme. Nëse dikush e tregon dashamirësi duke u tulatur pas dikujt, të tjerë ndoshta preferojnë të pikturojnë një pikturë për një njeri të dashur. Për fëmijët është e rëndësishme në zhvillimin e tyre që t'i dallohen ndjenjat si të tilla dhe t'i përdoren ato. Lidhur me këtë vlen:

- ▶ Fëmijët mund të tregojnë ndjenja, si pozitive, ashtu dhe negative. Çdo fëmijë mund ta bëjë në mënyrën e vetë, qoftë në mënyrë të zhurmshme, qoftë në mënyrë të qetë. Kohët kur djemtë nuk duhet të qanin dhe vajzat nuk duhet të bënin potere në mënyrë të zhurmshme, kanë kaluar.
- ▶ Ngandonjëherë të rriturit i gjejnë shpërthimet e ndjenjave të fëmijëve jo të përshtatshme. Të vegjlit mund të luten atëherë pa problem për vetëpërbajtjen. Por ata duhet të dinë që jo ndjenjat e tyre kanë qenë të papërshtatshme por sjellja e tyre.
- ▶ Fëmijët duan të merren seriozisht me ndjenjat e tyre. Në rast të katastrofave të vogla ose të mëdha ata nuk qëndrojnë mbi gjërat si disa të rritur. Për këtë duhet reaguar më së miri me gjakftohtësi.
- ▶ Disa vajza dhe djem preferojnë ta mbajnë për veten atë që i shqetëson. Nëse ata janë veçanërisht të dëshpëruar ose të qetë, atëherë prindërit duhet ta hulumtojnë shkakun. Edhe fëmijëve më shumë të përbajtur u vjen ngandonjëherë mirë që të zbrazin zemrën e tyre.



► Edhe në botën e ndjenjave mësojnë të vegjlit nga të mëdhenjtë. Prandaj edhe prindërit mund të tregojnë ndjenjat ndaj fëmijëve dhe mund t'i shpjegojnë në mënyrë të përshtatshme me moshën. Ata në asnjë mënyrë nuk lënë të gënjehen. Mirëpo e frikshme për fëmijë është

kur ata ndiejnë se ka diçka në ajër dhe të rriturit nuk i informojnë. Prindërit nuk janë mbrojtur nga shpërthime e ndjenjave të papërshtatshme ashtu si edhe fëmijët. Atëherë është e rëndësishme që më vonë të kërkohet falje. Një gabim i pranuar nuk është një dobësi!

Edukimi është ...  
që të kesh kohë.



---

Duke luajtur, folur, lexuar, zbuluar botën – fëmijët gjatë aktiviteteve të përbashkëta brenda familjes mësojnë shumë për të ardhmen. Dhe koha e kaluar së bashku e forcon lidhjen në mes të prindërve dhe fëmijëve. Shumë fëmijë dhe të rinj dëshirojnë që prindërit e tyre të kalojnë më shumë kohë bashkë me ata. Kështu mund të arrihet:

---

- ▶ Të kesh kohë nuk është e lidhur patjetër me aktivitete të shtrenjta. Një vizitë në pishinë, një ekskursion në kopshtin zoologjik ose me biçikletë me të gjithë familjen janë tepër të kërkuar nga fëmijët. Hobi të përbashkët ofrojnë një mundësi të mirë që të kalohet koha e lirë bashkërisht.
- ▶ Pikërisht në jetën e përditshme fëmijët kanë nevojë për kohë dhe vëmendje. Lidhur me këtë mund të lidhet e dobishmja me të këndshmen. Puna e përbashkët në shtëpi mund jetë e këndshme, nëse ajo nuk mbahet si detyrim i bezdisshëm. Disa familje mbyllin krejt „ngrënës të kohës“ si televizorin ose ‘Playstation’ për një fare kohë. Orët e bëra të lira mund të mbushen me shumë gjëra të mira.
- ▶ Prindërit duhet t’ua dhurojnë dashamirësi sidomos atëherë, kur ata kanë nevojë për këtë, kur detyrat e shtëpisë janë veçanërisht të vështira ose biçikleta nuk funksionon. Rituale si historia para zënies së gjumit kërkojnë ndoshta shumë kohë, por ato janë shumë të rëndësishme për fëmijët.
- ▶ Prindërit që për shkak të detyrimeve profesionale kanë më pak kohë për familjen nuk duhet të kenë ndërgjegje të keqe. Vendimtare është që orët në dispozicion të shfrytëzohen së bashku dhe me kuptim. Nëse koha është e ngushtë, atëherë ndërkohë lejohet që të tregohen të gatshëm edhe gjyshi dhe gjyshja, teza ose miq.



# Edukimi është ... që të japësh zemër.



Për çdo gjë të re që mësojnë dhe për detyrimet të cilët i marrin përsipër hap pas hapi, adoleshentët kanë nevojë për shumë kohë dhe vetëbesim. Atëherë ata mësojnë që të mbajnë përgjegjësi dhe të hapin rrugë vetes dhe nuk lënë që të futen shpejtë në pasiguri nga të tjerët. Që të zhvillojnë kurajë dhe vetëbesim, vajzave dhe djemve duhen dy gjëra: Kënaqësi me atë që kanë arritur dhe njohje e arritjeve nga ana e të tjerëve. Si mund të inkurajojnë prindërit fëmijët?

- ▶ Fëmijët duan të dashurohen si person dhe jo vetëm për shkak të arritjeve të tyre. Kaq shpejt sa mund të inkurajohen, ata mund të futen edhe në pasiguri. Prandaj të rritur duhet të sillen me kujdes me ata.
- ▶ Kush do të marrë zemër ka nevojë për shije suksesi. Nëse fëmijë provojnë diçka dhe lejohen të bëjnë gabime gjatë kësaj, atëherë ata marrin parasysh edhe gërvishtje dhe aksidente të vogla. Me marrjen përsipër të detyrave të vogla dhe përgjegjësi inkurajohen fëmijët.
- ▶ Fëmijët kanë nevojë për lavdërim. Jo gjithmonë vetëm rezultati meriton miratim, por ngandonjëherë thjeshtë mundimi për të arritur diçka. Por lavdërimi duhet të dozohet mirë, përndryshe ai nuk ka më vlerë kur duhet të vlerësohet një sukses. Ndihe ma të vogla parandalojnë mërzinë e

kotë të fëmijëve. Që në blerje mund të zgjidhni p.sh. rroba të cilat edhe të vegjlit mund të vishen vetë.

► Edhe këtu vlen: Të rritur që u lejojnë gabime fëmijëve, mund të bëjnë edhe vetë gabime.



# Këshilla dhe ndihma për familje të forta.



---

Asnjëri nuk mund dhe duhet të jetë një „makinë edukimi“. Babai i përsosur ose nëna e pagabueshme janë më tepër një ankth për fëmijët. Prandaj ne në fund dëshirojmë guxim për familjen jo të përsosur. Të gjithë prindërit ju afruakëshin herë pas here kufijve të tyre. Atëherë ata kanë nevojë për njeri i cili u dëgjon atyre, ua jep zemër dhe hapësirë të lirë.

---

- ▶ Pranojeni nëse fuqia juaj ka marrë fund. Kjo nuk është turp, por një hap i parë i guximshëm.
- ▶ Ia lejon vetes herë pas here pushim nga jeta e përditshme e edukimit. Ngandonjëherë mjafton që të keni një herë në javë disa orë – pa fëmijë – për vete, qoftë për të shkuar në pishinë, për të vizituar një kurs në shkollën e lartë popullore ose për t’u takuar me miq. Edhe partneriteti ka nevojë për përkujdesje që ai të japë përsëri vull për të gjithë familjen.

- ▶ Afrohuni të tjerëve nëse keni nevojë për mbështetje. Komshinjtë, të afërmit ose miqtë, por edhe këshillimoret ju ndihmojnë me gjithë qejf.

Ne shpresojmë që t’ju mund të mbështesim me fushatën “1/e fortë me edukim” në detyrën tuaj. Dhe ne duam t’u shtojmë „Tetë çështjeve që e bëjnë edukimin të fortë“ edhe dy pika të tjera: Një racion logjik të shëndetshme njerëzore dhe një grimë të fortë humori. Kështu mund të formohet me qetësi jeta e përditshme e edukimit.

## LINKE-T E DOBISHME:

Në Bayern:

[www.baer.bayern.de](http://www.baer.bayern.de)

[www.elternbriefe.bayern.de](http://www.elternbriefe.bayern.de)

[www.erziehungsberatung.bayern.de](http://www.erziehungsberatung.bayern.de)

[www.familienbildung.bayern.de](http://www.familienbildung.bayern.de)

[www.familienhandbuch.de](http://www.familienhandbuch.de)

[www.familienstuetzpunkte.bayern.de](http://www.familienstuetzpunkte.bayern.de)

[www.koki.bayern.de](http://www.koki.bayern.de)

[www.stmas.bayern.de](http://www.stmas.bayern.de)

Në te gjithë shtetin :

[www.bke-elternberatung.de](http://www.bke-elternberatung.de)

[www.bzga.de](http://www.bzga.de)

[www.familienportal.de](http://www.familienportal.de)

# # BAYERN. GEMEINSAM. STARK.

[www.stark-durch-erziehung.de](http://www.stark-durch-erziehung.de)

---



Die Kampagne „Stark durch Erziehung“ will alle, die an der Erziehung junger Menschen beteiligt sind, unterstützen und stärken. Das Thema soll verstärkt ins Gespräch gebracht werden. Die Broschüre kann in 16 verschiedenen Fremdsprachen unter [www.stark-durch-erziehung.de](http://www.stark-durch-erziehung.de) heruntergeladen werden. Wir danken dem Jugendamt Nürnberg für die Entwicklung des Projekts, das mit Mitteln des Staatsministeriums für Familie, Arbeit und Soziales gefördert wurde.

---



Dem Bayerischen Staatsministerium für Familie, Arbeit und Soziales wurde durch die berufundfamilie gemeinnützige GmbH die erfolgreiche Durchführung des audits berufundfamilie® bescheinigt: [www.beruf-und-familie.de](http://www.beruf-und-familie.de)

---



Wollen Sie mehr über die Arbeit der Bayerischen Staatsregierung erfahren? BAYERN DIREKT ist Ihr direkter Draht zur Bayerischen Staatsregierung. Unter Telefon 089 122220 oder per E-Mail unter [direkt@bayern.de](mailto:direkt@bayern.de) erhalten Sie Informationsmaterial und Broschüren, Auskunft zu aktuellen Themen und Internetquellen sowie Hinweise zu Behörden, zuständigen Stellen und Ansprechpartnern bei der Bayerischen Staatsregierung.

---



Bayerisches Staatsministerium für  
Familie, Arbeit und Soziales

Winzererstr. 9, 80797 München

E-Mail: [oeffentlichkeitsarbeit@stmas.bayern.de](mailto:oeffentlichkeitsarbeit@stmas.bayern.de)

Gestaltung: Serviceplan MAKE GmbH & Co. KG

Bildnachweis: shutterstock.com

Stand: Februar 2023

Artikelnummer: 1001 0600, Sprache: Albanisch

Bürgerbüro: Tel.: 089 1261-1660

E-Mail: [buergerbuero@stmas.bayern.de](mailto:buergerbuero@stmas.bayern.de)

Web: [www.stmas.bayern.de/buergerbuero](http://www.stmas.bayern.de/buergerbuero)

---

Hinweis: Diese Druckschrift wird im Rahmen der Öffentlichkeitsarbeit der Bayerischen Staatsregierung herausgegeben. Sie darf weder von Parteien noch von Wahlwerbern oder Wahlhelfern im Zeitraum von fünf Monaten vor einer Wahl zum Zwecke der Wahlwerbung verwendet werden. Dies gilt für Landtags-, Bundestags-, Kommunal- und Europawahlen. Missbräuchlich ist während dieser Zeit insbesondere die Verteilung auf Wahlveranstaltungen, an Informationsständen der Parteien sowie das Einlegen, Aufdrucken und Aufkleben parteipolitischer Informationen oder Werbemittel. Untersagt ist gleichfalls die Weitergabe an Dritte zum Zwecke der Wahlwerbung. Auch ohne zeitlichen Bezug zu einer bevorstehenden Wahl darf die Druckschrift nicht in einer Weise verwendet werden, die als Parteinahme der Staatsregierung zugunsten einzelner politischer Gruppen verstanden werden könnte. Den Parteien ist es gestattet, die Druckschrift zur Unterrichtung ihrer eigenen Mitglieder zu verwenden.